



Prishtinë, 06 prill 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1244\_2020

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastradastrave Nr. 6139-4 dhe 6138-1 ZK Rahovec, me kapacitet të instaluar prej 8.4 kW në Komunën e Rahovecit, të datës 03.03.2020 me nr. prot. 128/2020 të aplikuesit "Samiri-I-H&A" SH.P.K., me adresë: rruga Xhelal Hajda Toni, Komuna Rahovec, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 06 prill 2020 nxori këtë:

**V E N D I M**

**PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "Samiri-I-H&A" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin e ndërtuar sipas Aktvendimit nr. 12. Nr. 40 të datës 24.02.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjen e Mjedisit, në parcelën ngastradastrave Nr. 6139-4 dhe 6138-1 ZK Rahovec, me kapacitet të instaluar prej 8.4 kW që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Rahovecit.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi "Samiri-I-H&A" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DGJ-80000031 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtoj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE** do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi "Samiri-I-H&A" SH.P.K.,** do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.


**A r s y e t i m**




- o ZRRE, me datë 03.03.2020 nga aplikuesi "Samiri-I-H&A" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastra kadastrave Nr. 6139-4 dhe 6138-1 ZK Rahovec, me kapacitet të instaluar prej 8.4 kW shifra e konsumatorit DGJ- 80000031 që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Rahovecit.
  - o Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik Nr. 1386 të datës 18.02.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Aktvendimin 12 Nr. 40 të datës 24.02.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Rahovecit.
  - o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "Samiri-I-H&A" SH.P.K., dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin parcelën ngastra kadastrave Nr. 6139-4 dhe 6138-1 ZK Rahovec, me kapacitet të instaluar prej 8.4 kW që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Rahovecit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. kryesues

  
Besim Beqiraj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Ruzhiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Rahovecit,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.